



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 79/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Koalicionit VAKAT në Prizren, paraqitur kundër Vendimit nr. 1128/2014 të dt. 27.05.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Prishtinë, për shkak të lidhur me ndalimin e publikimit të posterave promovues, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 29.05.2014, mori këtë:

V E N D I M

I APROVOHET apeli i Koalicionit VAKAT, si i bazuar.

II ANULOHET, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 1128/2014 i datës 27.05.2014.

Arsyetim

Me datën 27.05.2014, PZAP-i, ka pranuar një apel nga Koalicionit VAKAT, në të cilin pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në takimin e saj të radhës të mbajtur me dt. 27.05.2014, ka marr vendim për ndalimin e publikimit të posterave promovues të madhësisë B2, në vendet e shënuara për reklamimin e partive politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Ky vendim i KQZ-së sipas parashtruesit të apelit është në kundërshtim me nenin 44.1 të LZP-së dhe ndërhy në të drejtat e subjekteve politike dhe në reklamimin e tyre gjë që është e garantuar me këtë ligj. Me këtë rast, shton se janë duke u dëmtuar nga ky ndalim i reklamimit sepse mënyrat e tjera të reklamimit kanë kosto të lartë të shpenzimeve dhe se nuk mundën ti përballojnë.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 28.05.2014, për apelin që është bërë ndaj vendimit të saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit në fjalë deri më datë 29.05.2014 në ora 10:00. PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja, në të cilën theksohet se me datën 27.09.2013 KQZ-ja ka marr Vendim për të ndaluar publikimin e posterave promovues me qëllim për të parandaluar problemet eventuale në mes të subjekteve politike lidhur me hapësirat publike për vendosjen e posterave si dhe me qëllim të ruajtjes së ambientit në hapësirat publike.

Më tej në përgjigje në ankesë nga KQZ-ja theksohet se pohimi i Koalicionit VAKAT nuk qëndron, pasi që me asnjë Akt ligjor dhe nënligjor nuk janë specifikuar hapësirat për vendosjen e posterave promovues.

Mirëpo, me Vendimin e saj KQZ ka ndaluar vetëm publikimin e posterave promovues të formatit B2 që nuk ka të bëjë me ndalimin e formave tjera.

PZAP-i, pasi analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

apeli është i bazuar

Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), dhe Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013 “*Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*”, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Në kuptim të nenin 44 par. 1 pika (b) të LZP-së, sipas kushteve të saktësuar në Kodin e Mirësjelljes gjatë Periudhës së Fushatës Zgjedhore, subjektet politike kanë të drejtë të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe çfarëdo çofshin ato pa ndonjë kufizim përkitazi me madhësisë (dimensioneve të tyre), reklamave dhe materialeve tjera në një fushatë zgjedhore.

Me vendimin e ankimuar është vepruara në kundërshtimin më këtë dispozitë ligjore, dhe për më tepër KQZ-ja me asnjë vendim të saj, subjekteve politike apo garuesve në zgjedhje nuk mund t’ua kufizoj apo ndaloj të drejtat të cilat atyre ju takojnë sipas ligjit.

Nga kjo del se me asnjë dispozitë të LZP-së e as me Rregulla Zgjedhore nuk parashihet ndalimi i publikimit të posterave promovues “B2” të kandidatëve të cilët janë të certifikuar për të marr pjesë në garën për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvend të Republikës së Kosovës.

Andaj duke u bazuar ne arsyet e lartcekura, si dhe ne pajtim me dispozitat e cituara, ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-se dhe lidhur me nenin 209 pika (d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 79/2014 më datën 29.05.2014.

Kryesuesi i panelit
Hasan Shala



PZAP nuk do t’i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*